1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.



---

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II:LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>3</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontratës;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

<sup>3</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>		<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimeve</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b>	
1	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në qendër	Copë	2			
2	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në nyjat kryesore	Copë	12			
3	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në nyjat dytësore	Copë	14			
4	Suport nga prodhuesi - Sistemi i monitorimit dhe manaxhimit të pajisjeve të rrjetit	Copë	1			
5	Mirëmbajtja e sistemit	Set	1			
<b>Totali i çmimeve (Shërbimet)</b>						_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						

---

### Shtojca 3.

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* ]

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

[ **Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit** ]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

*(<sup>4</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>4</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



---

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimi që kërkohet:**

“Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit OSPF\_HPE në nivelet 1/2/3, për një periudhë 24 mujore”, sipas Termave të References.

**Afatet e ekzekutimit:** 24 (njëzet e katër) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përcaktimeve të bëra në Termat e References.

1	Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit OSPF_HPE në nivelet 1/2/3, për një periudhë 24 mujore			24 (njëzet e katër) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.
---	--	--	--	---

---

## Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

PËRMBAJTJA .....	Error! Bookmark not defined.
<b>1.Përfituesi / Autoriteti Kontraktues .....</b>	<b>25</b>
1.1.Historiku .....	25
<b>2.QËLLIMI I SHËRBIMIT .....</b>	<b>25</b>
2.1.Objektivi I përgjithshëm .....	25
<b>3.SUPOZIMET DHE RISQET .....</b>	<b>26</b>
3.1.Supozimet e Projektit .....	26
3.2.Risqet .....	27
<b>4.AFATI I SHËRBIMIT .....</b>	<b>27</b>
<b>5.INFRASTRUKTURA FIZIKE (HARDWARE) EKZISTUESE .....</b>	<b>27</b>
<b>6.SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT .....</b>	<b>37</b>
<b>7.PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT .....</b>	<b>37</b>
<b>8.OBJEKTI I KËRKESËS : .....</b>	<b>38</b>

## **1. Përfituesi/ Autoriteti Kontraktues**

---

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

### **1.1. Historiku**

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar me datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në tre shoqëri të veçanta. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

1. Furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
2. Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
3. Tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit;

## **2. QËLLIMI I SHËRBIMIT**

---

### **2.1. Objektivi I përgjithshëm**

---

Objektivi i përgjithshëm i projektit do të jetë rinovimi i suportit nga prodhuesi dhe mirëmbajtja e pajisjeve hardware/software, ç'ka do t'i mundësojë sistemit SCADA në OST komunikim fleksibël të sigurtë të nyjeve periferike (RTU dhe LCS) të instaluar në sistemin energjistik të Shqipërisë.

**Nëpërmjet këtij projekti synohet:**

- Rinovimi i suportit hardware nga prodhuesi;
- Rinovimi i suportit për licensa dhe SW Updates
- Diagnostikim i pajisjeve Hardware dhe suport remote
- Zëvendësimi i produktit në rast difekti
- Dërgimi i pajisjeve nga HPE drejt Operatorit në termin “Ditën tjetër të Biznesit”
- Ofrimin e shërbimit 24 orë cdo ditë të javës (24x7)
- Suport teknik software 24x7
- Update i software sipas rekomandimeve të HPE

**Garancia dhe suporti**

- Garancia për pajisjet kërkohet të jetë sipas specifikimeve teknike.
- Shërbimi i Suportit do të jetë për 2 vite, me disponueshmëri 24x7.
- Gjatë periudhës së suportit kërkohet gjithashtu përditësimi me versionet e fundit falas për software.
- Suporti dhe garancia duhet të përmbajë zëvendësimin falas për produktet hardware.

**Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori**

- Kontraktori duhet të ofrojë garanci për suport për pajisjet e instaluar, aktualisht në gjendje pune.
- Kontraktori duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qendërimit të thirrjeve dhe të një kontakti të vetëm që koordinon dhe manaxhon thirrjet e OST sh.a.
- Kontraktori duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 4 orë nga logimi i thirrjes.
- Specialisti/inxhinieri duhet të paraqitet në vendndodhjen e OST sh.a. sipas tabelës së kategorizimit më poshtë. Gjatë kohës së paracaktuar, specialisti duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Kontraktori duhet të sigurojë gadishmërinë e suportit 365/7/24.
- Kontraktori duhet të sigurojë garanci për suport të plotë të hardware-t me zëvendësim falas të pajisjes.
- Në rast ndërrimi të pajisjeve, kontraktori ofruar i garancisë për suport duhet të ndërrojë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Kontraktori duhet të kryejë në mënyrë periodike mirëmbajtje preventive me qëllim eliminimin e ndërprerjeve të padëshiruara të shërbimit.

### **3. SUPOZIMET DHE RISQET**

---

#### **3.1. Supozimet e Projektit**

Faktorët që supozohet se mund të kenë ndikim në ecurinë e projektit janë :

Bashkëpunimi dhe koordinimi midis stafit të koontraktorit që do të kryejë mirëmbajtjen dhe stafit përgjegjës të OST sh.a.

### 3.2. Risqet

Në risqet që paraqiten për mbarëvajtjen e problemit janë:

- Zbatimi i kushteve dhe parametrave teknike
- Përgatitja dhe njohuritë e stafit të kontraktorit
- Gjenerim i evidencave dhe raporteve të ndryshme

## 4. AFATI I SHËRBIMIT

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 2-vjeçare.

## 5. INFRASTRUKTURA FIZIKE (HARDWARE) EKZISTUESE

Në tabelat e mëposhtme jepen pajisjet e infrastrukturës fizike ekzistuese bashkë me markën, modelin e tyre. Gjithashtu në të përfshihen dhe Part Number dhe Serial Number (aty ku është e aplikueshme).

### Switch-e në qendër

<b>Core Switch - HPE 5520 24G 4SFP+ HI Switch (2 copë)</b> <i>(P/N: R8M25A, SN: CN20L4000M, CN20L4005V)</i>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshire;
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• 16 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li><li>• 4 porta 10Gb që suportojne transceivera SFP/SFP+;</li><li>• Të paktën 8 porta me support për MACsec;</li><li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li><li>• 1 portë USB 2.0;</li><li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li><li>• 1 slot i lirë për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps</li><li>• Kablla stakimi të përfshire;</li></ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• 512 MB flash;</li><li>• 2 GB SDRAM;</li><li>• 4 MB Madhësia e Packet buffer;</li></ul>
<b>Throughput/Performance.</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• 180 Mpps throughput;</li><li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 288 Gbps;</li><li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li><li>• Tabela e adresave MAC: 64K;</li><li>• Vonesa (latency) më e vogël se 5 µs (porta 1 ose 10 Gbps);</li><li>• Lista kontroll aksesi: ACL hyrëse(ingress) minimumi 2K;</li></ul>
<b>Power supply</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Hapësire për 2 blloqe ushqimi;</li><li>• Është i pajisur me dy blloqe ushqimi AC;</li></ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajisje në një stack, duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si</li></ul>

	<p>një pajisje e vetme qe lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji e avancuar për ndërlidhjen për standarded OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Suporton standardin IEEE 802.1Q, minimumi 1000 VLAN ID dhe standardin IEEE 802.1ad QinQ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin më të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me ane te protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> <li>• Support për Jumbo frame 10 000 byte;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim në IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim në IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Ofron ndërfaqe të adresueshme Loopback;</li> <li>• Standartet për tunelim te IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim në Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM; si dhe ofron mundësi për menaxhim të adresave multicast dhe frenim të sulmeve DoS;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE per VPN që mundëson tunelim të Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofron MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS);</li> <li>• Ofron VxLAN dhe EVPN;</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll më të mirë në shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrimet trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, ne VLAN dhe në portë;</li> <li>• ACL në hardware me TCAM;</li> <li>• Menaxhim me SSH, HTTP (TLS), SNMPv3 dhe me server qëndror të tipit RADIUS dhe TACACS;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofron mbrojtje nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar në: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuara nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Suporton funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Suporton standardet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Ofron limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast të panjohur;</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim në distancë në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, Web UI, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan në disa versione filet e konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar;</li> <li>• Port mirroring me aftësi për të përzgjedhur ne baze ACL trafikun hyrës/dalës nga një porte ose nje VLAN dhe te pasqyroje atë në një porte lokale ose ne remote;</li> <li>• SNMP v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licensimi</b>	E licensuar për te gjitha karakteristikat dhe kapacitetet më sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	<p>Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius</p> <p>Lagështira relative e operimit: 10% to 95%, pa kondensim</p>
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim te pajisjes ne ditën vijuese te punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit te përfshira

### Switch-e në nyjat kryesore (6x2 cope)

<b>Switch Multi Layer -HPE 5520 24G 4SFP+ HI Switch (12 copë)</b>	
<i>(P/N: R8M25A, SN: CN20L40081, CN20L4007Y, CN20L4002S, CN20L40016, CN20L400DB, CN20L400CL, CN20L400HL, CN20L400KR, CN20L40024, CN20L40019, CN20L4005R, CN20L400C5)</i>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo më shumë se 40 cm, aksesoret e përfshirë.

<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb qe suportojne transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë USB 2.0;</li> <li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lirë për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps</li> <li>• Kabllo stakimi e përfshirë;</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, ofron switchim wire-speed;</li> <li>• 180 Mpps throughput;</li> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 280 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 32K;</li> <li>• Vonesa më e vogël se 5 µs ne portat 1 ose 10 Gbps;</li> <li>• Lista kontroll aksesi: ACL në 3K hyrëse(ingress) dhe 1K dalëse(egress);</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësire për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• I pajisur me një bllok ushqimi DC -48 VDC;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajise në një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• In service software upgrade;</li> <li>• Teknologji të avancuara nga ku përfshihen standardet e industrisë për OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i standardit IEEE 802.1Q VLAN, 4094 ID;</li> <li>• Standardi IEEE 802.1ad QinQ ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin me të mirë të linjave për te rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me ane te protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> </ul>

<p><b>Karakteristikat e shtresës L3</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim ne IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Ofron ndërfaqe Loopback të adresueshme;</li> <li>• Standardet për tunelim te IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim në Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE për VPN që mundëson tunelim të Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<p><b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofron MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS);</li> <li>• Equal-Cost Multipath (ECMP);</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll më të mirë në shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<p><b>Siguria</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, në VLAN dhe në porte;</li> <li>• ACL në hardware me TCAM;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve të industrisë në bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Manaxhim me SSHv2, HTTPS, SNMPv3 dhe me server qendror te tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar ne adresat MAC me Radius Server;</li> <li>• Kontroll aksesi bazuar ne identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN ne nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<p><b>QoS</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Suporton funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Suporton standardet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Ofron limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast të panjohur;</li> </ul>



<b>Manaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim në distance në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit te operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan në disa versione filelet e konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuara;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për te përzgjedhur në baze ACL trafikun hyrës/dalës nga një portë ose VLAN dhe të pasqyroje atë në një porte lokale ose remote.</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja Switch është e licencuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet më sipër.</li> </ul>
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	<p>Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius</p> <p>Lagështira relative e operimit: 15% to 90%, pa kondensim</p>
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim të pajisjes në ditën vijuese të punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit të përfshira.

### Switch-e në nyjat dytësore

<b>Switch Multi-Layer -HPE 5520 24G 4SFP+ HI Switch (14 copë)</b>	
<i>(P/N:R8M25A, SN: CN20L4001F, CN20L400GL, CN20L40011, CN20L400C8, CN20L4002Q, CN20L400D9, CN20L4001G, CN20L4002Y, CN20L400GB, CN20L4001B, CN20L40017, CN20L400CB, CN20L40015, CN20L400DG)</i>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo më shumë se 40 cm  aksesorët e përfshire.
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb qe suportojne transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë USB 2.0;</li> <li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lire për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, ofron switchim wire-speed;</li> <li>• 160 Mpps throughput;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 220 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 32K;</li> <li>• Vonesa më e vogël se 5 μs në portat 1 ose 10 Gbps;</li> <li>• Lista kontroll aksesi: ACL ne 3K hyrëse(ingress) dhe 1K dalëse(egress);</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirë për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• Është i pajisur me një bllok ushqimi DC -48 VDC;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajise në një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme qe lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• In service software upgrade;</li> <li>• Teknologji të avancuara nga ku të përfshihen standardet e industrisë për OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i standardit IEEE 802.1Q VLAN, 4094 ID;</li> <li>• Standardi IEEE 802.1ad QinQ ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin më të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me anë të protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim ne IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Ofron ndërfaqe Loopback te adresueshme</li> <li>• Standardet për tunelim të IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim në Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE për VPN që mundëson tunelim të Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofron MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS)</li> <li>• Equal-Cost Multipath (ECMP);</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll më të mirë në shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) qe suportojne filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, në VLAN dhe në porte;</li> <li>• ACL ne hardware me TCAM;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve të industrisë në bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Manaxhim me SSHv2, HTTPS, SNMPv3 dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar në adresat MAC me Radius Server;</li> <li>• Kontroll aksesi bazuar në identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN në nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Suporton funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Suporton standardet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Ofron limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast te panjohur.</li> </ul>
<b>Manaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim në distance në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit te operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan në disa versione filet e konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje te caktuar;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për të përzgjedhur në bazë ACL trafikun hyrës/dalës nga një porte ose VLAN dhe te pasqyroje atë në një portë lokale ose remote;</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	Pajisja Switch është e licencuar për te gjitha karakteristikat dhe kapacitetet më sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	<p>Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius;</p> <p>Lagështira relative e operimit: 15% to 90%, pa kondensim ;</p>

---

<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim të pajisjes në ditën vijuese të punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit të përfshira.
-----------------	--

### **Sistemi i monitorimit dhe manaxhimit të pajisjeve të rrjetit**

**P/N:** R8M25A

**Përshkrimi:** HPE IMC Std SW Plat w/50-node E-LTU

**S/N:** PRSW2307070191

Zgjidhja e ofruar bazohet në modelet dhe praktikat e ITIL.

Ofron menaxhim të burimeve për të lejuar administrimin e pajisjeve nga prodhues të ndryshëm nëpërmjet një portali të vetëm. Administratorët monitorojnë ‘shëndetin’ e pajisjes nëpërmjet detajeve të statusit së saj, duke zbuluar të dhëna në kohë reale, informacione përmbledhëse, testime të komunikimit, etj.

Ofron menaxhim të aseteve të rrjetit për të gjurmuar në çdo kohë asetet dhe ndryshimet në to.

Mundëson menaxhimin e gabimeve dhe defekteve në kohë reale. Integrimi i sistemit të menaxhimit të rrjetit të defekteve, performancës, auditimit, sigurisë, konfigurimeve zvogëlon kohën dhe përpjekjet e për të menaxhuar infrastruktura rrjeti komplekse.

Ofron mundësinë e zgjerimit të menaxhimit të infrastrukturës së institucionit në mënyrë të shkallëzuar dhe pa shkaktuar ndërprerje për të implementuar teknologjitë e reja në të njëjtën kohë.

Suporton dhe menaxhojë pajisje nga prodhues të ndryshëm, si Cisco, HPE, Fortinet, etj. Është kompatibël me sisteme operative si Microsoft Windows dhe Linux. Suporton bazat e të dhënave si Oracle, Microsoft SQL Server, MySQL, etj.

Mundëson përdorimin e një paneli të qendëruar për menaxhimin nga pika në pikë të procesit të shërbimeve TLC.

Mundëson menaxhimin e konfigurimeve dhe ndryshimeve të tyre. Administratorët dhe operatorët monitorojnë, instalojnë programe në pajisje, aksesojnë modele konfigurimi, përdorin libraritë e programeve, fshijnë konfigurimet në pajisje për t'i zhvendosur në pozicione të reja, bëjnë backup të konfigurimeve, etj.

Mundëson menaxhimin e burimeve për të siguruar zbulimin e rrjetit dhe topologjinë e tij, duke përfshirë inventarin e saktë dhe të detajuar të pajisjeve dhe konfigurimeve. Në pamjet që ofrohen përfshihen Layer 2 dhe 3, si dhe topologjia VLAN. Ka aftësinë për të krijuar pamje të personalizuar si një ndërfaqe e panelit të kontrollit.

Mundëson përdorimin e një modeli SOA për të ofruar menaxhim të plotë të burimeve, shërbimeve dhe përdoruesve.

---

Mundëson integrimin e mjeteve tradicionalisht të veçanta të menaxhimit duke përdorur një dizajn modular.

E licensuar për të menaxhuar të paktën 100 pajisje dhe mundësi të zgjerohet në të ardhmen, sipas nevojave të institucionit.

Suporton kontrollet administrative bazuar në role, për t'u ofruar administratorëve mjetet e nevojshme dhe mundësinë për të granular aksesin e operatorëve sipas nevojave.

Mundëson menaxhim të infrastrukturës virtuale me qëllim:

- integrimin, zbulimin, menaxhimin dhe monitorimin e mjediseve të virtualizuara, për të lejuar identifikimin e përhapjes së VM;
- të ofrojë njohuri dhe mjete për menaxhimin e rrjeteve virtuale për të reduktuar kompleksitetin e integritit.
- të suportojë platformat VMware, Hyper-V, KVM, etj.

Mundëson raportim fleksibël dhe të centralizuar për pajisjet e rrjetit, konfigurimet, ndryshimet në konfigurime, statusin e komunikimit, gjendjen e pajisjeve, alarme të ndryshme, etj. Llojet e raporteve të ofruara duhet të jenë në kohë reale dhe të personalizuar. Të dhënat e pajisjes duhet të jenë për statusin, etiketën, adresën IP, adresën MAC, llojin e pajisjes, modelin, prodhuesin, vendndodhjen dhe shumë të tjera.

Mundëson menaxhim global të listave të aksesit (ACL) për t'u ofruar operatorëve një grup funksionesh gjithëpërfshirës për menaxhimin e listave të aksesit, duke përfshirë monitorimin, konfigurimin e listave në pajisjet e menaxhuara, importimin e listeve, etj.

Ofron menaxhim global të VLAN, duke u dhënë administratorëve mundësinë për të krijuar VLAN-e të standardizuara në të gjitha pajisjet në infrastrukturë. Administratorët dhe operatorët krijojnë VLAN-e, pastaj shtojnë, konfigurojnë ose heqin ato nga të gjitha pajisjet që mbështesin këtë veçori.

Mundëson një qendër të kontrollit të sigurisë me qëllim përcaktimin e politikave dhe zbatimin e tyre në konfigurimet e pajisjeve. P.sh. mund të përdoren politika për të menaxhuar VLAN-et për t'u implementuar automatikisht sipas modelit të përcaktuar në pajisjet e sapo zbuluara.

Mundëson monitorim dhe menaxhim të performancës. Veçoria e menaxhimit të performancës ofron mundësinë të personalizojë mbledhjen e të dhënave, alarmet e ndryshme dhe detaje të performancës jo vetëm në kohë reale, por të mbledhë të dhëna nga historiku i menaxhimit të pajisjeve, si routers, switches, etj., për të dhëna të tipeve si IPSec, VPN, WSM, QOS, etj.

Mundëson mbledhjen e të dhënave nga pajisjet e rrjetit. Kjo veçori lejon mbledhjen e të dhënave që janë përzgjedhur dhe të gjenerojë raporte dhe skedarë të dhënash që përmbajnë informacionet përkatëse. Raportet duhet të dërgohen në destinacionin përkatës nëpërmjet email, FTP, SFTP ose në një vendndodhje "file share".

Ndërfaqja e përdoruesit duhet intuitive dhe ofron disa ndërfaqe të personalizuar, të bazuara në ikona, të cilat mund të organizohen sipas detyrave specifike. Mundëson krijimin e një menu/tab 'Të preferuara' për të aksesuar veçoritë që përdoren më shpesh nga operatorët. Gjithashtu, mundëson aksesimin e një destinacioni nëpërmjet disa rrugëve të ndryshme.

---

Ofron modele implementimi elastike dhe të shkallëzuara duke mundësuar menaxhimin e rrjeteve komplekse dhe heterogjene si dhe të ofrojë disponueshmëri të lartë. Ofron dizajn modular për t'u implementuar në disa servera për një shkallëzim dhe qëndrueshmëri sa më të lartë.

Suporton Telnet/SSH proxy me qëllim që një administrator mund të përdorë një shfletues për të aksesuar dhe menaxhuar nga distanca pajisjet, pa instaluar një mjet/aplikim në kompjuterin e klientit që përdoret për të aksesuar pajisjen.

Mundëson monitorimin e disponueshmërisë dhe reagimin e shërbimeve të rrjetit nëpërmjet modeleve që janë konfiguruar. Në këtë mënyrë mund të monitorohen protokolle si: TCP, UDP, DNS, FTP, HTTP, VoIP, SMTP, DHCP, ICMP, Radius, TACACS”, etj.

## **6. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT**

---

### **6.1. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes së Platformës Hardware**

Duke u mbështetur në informacionin e dhënë më sipër Kontraktori duhet të jetë i aftë të mirëmbajë këto pajisje me ndihmën e prodhuesve.

### **6.2. Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjet**

Gjatë realizimit të këtij shërbimi, Kontraktori do të jetë përgjegjës për:

- Mirëmbajtjen e pajisjeve switch në qendër
- Mirëmbajtjen e pajisjeve switch në nyjet kryesore
- Mirëmbajtjen e pajisjeve switch në nyjet dytësore
- Mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin dhe manaxhimin e pajisjeve të rrjetit dhe integrimin në të pajisjeve të së njëjtës familje produktesh, brenda numrit të licensave të lira në Sistemin e Monitorimit dhe Manaxhimit të Pajisjeve të Rrjetit

### **6.3. Shërbime riparimi:**

Kompania duhet të jetë e disponueshme për të ofruar Shërbime të riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli I autorizuar. Për këtë qëllim, me termin “Alarm Madhor” do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të proceseve të punës në OST.

## **7. PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT**

---

<b>Kategoria A ( Kritik/ I Larte)</b>	<b>Kategoria A (I Mesem)</b>	<b>Kategoria C (I Ulet)</b>
Mos funksionimi i aplikacionit	Mos funksionimi i aplikacionit	Mos funksionimi i aplikacionit

krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal.	krijon vonesa në aktivitetin normal.	pengon në mënyrë minimale aktivitetin.
<b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <b>shumë të madh</b> të përdoruesve.	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <b>të vogël</b> të përdoruesve.	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues.
<b>Pezullimi i punës</b>		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u></b>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë pjesë të punës së tyre.</u></b>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre.</u></b>
<b>Zgjidhje alternative e përkohshme</b>		
<b><u>Nuk ka një mënyrë alternative</u></b> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<b><u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u></b> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<b><u>Ka një mënyrë alternative</u></b> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
<b>Koha e përgjigjes</b>		
<input type="radio"/> 4 orë për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 24 orëve	<input type="radio"/> 8 orë për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 48 orëve	<input type="radio"/> 24 orë për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 72 orëve
<b>Koha e zgjidhjes</b>		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 5 dite pune pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë pune pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 15 ditë pune pas kërkesës.

## 8. OBJEKTI I KËRKESËS :

Shërbim i mirëmbajtjes së rrjetit OSPF për një periudhë 24 muaj.

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia	Afati
1	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në qendër	Copë	2	24 muaj
2	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në nyjat kryesore	Copë	12	24 muaj

---

3	Suport nga prodhuesi - Pajisje aktive rrugëzimi në nyjat dytësore	Copë	14	24 muaj
4	Suport nga prodhuesi - Sistemi i monitorimit dhe manaxhimit të pajisjeve të rrjetit	Copë	1	24 muaj
5	Mirëmbajtja e sistemit	Set	1	24 muaj

**Shenim:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**



---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
